

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-163/2014

Prishtinë, 1 qershor 2016

Në çështjen juridike të:

I.A.

Raushiq,

Pejë

Pala ankuese

Kundër.

M.Z.

Berane,

Mali i Zi

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami si kryetar i kolegjit, Rolandus Bruin dhe Anna Bednarek gjyqtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (tani e tutje: KKPK) nr. KPCC/D/C/208/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrat KPA17993, KPA28947, KPA29087, KPA29088 dhe KPA29108) të datës 11 qershor 2013, pas këshillimit të mbajtur më 1 qershor 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesat e paraqitura nga I.A. , të regjistruara me numër GSK-KPA-A-163/2014, GSK-KPA-A-164/2014, GSK-KPA-A-165/2014, GSK-KPA-A-166/2014 dhe GSK-KPA-A-167/2014, bashkohen në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-163/2013.
2. Ankesat e paraqitura nga I.A. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/C/208/2013 të datës 16 qershor 2013 sa i përket kërkesave me numër KPA17993, KPA28947, KPA29087, KPA29088 dhe KPA29108 hedhen poshtë si të paafatshme.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 15 shkurt 2007, 13 mars 2007, 29 mars 2007 dhe 22 gusht 2007, M.Z. , (tani e tutje: pala përgjegjëse në ankesë) ka paraqitur pesë kërkesa të ndara pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP), me të cilat ka kërkuar ri-posedimin e tokës dhe të instalimeve (mullirit elektrik, trafo-stacionit, gypave të ujësjellësit dhe linjës së rrymës) në ngastrën kadastrale nr. 451/12 e cila gjendet fshatin Brezhanik, Zona Kadastrale Bellopojë, Komuna e Pejës (tani e tutje: prona e kërkuar). Pala përgjegjëse në ankesë pretendon se është pronar i ngastrës kadastrale nr. 451/12 dhe i objekteve – lokaleve afariste – që gjenden si në vijim:
 - GSK-KPA-A-163/14 (KPA17993) lokal afarist (mullirit elektrik) dhe tokës,
 - GSK-KPA-A-164/14 (KPA28947) linjës së rrymës dhe rrjetit të ujësjellësit,
 - GSK-KPA-A-165/14 (KPA29087) mullirit elektrik,
 - GSK-KPA-A-166/14 (KPA29088) trafo-stacionit dhe 870 metra të linjës së rrymës
 - GSK-KPA-A-167/14 (KPA29108) sistemit të rrjetit të ujësjellësit (800 m).
2. Në kërkesa pala përgjegjëse në ankesë ka deklaruar se pronat e kërkuara i ka humbur si rezultat i konfliktit të armatosur që ndodhi në Kosovë në periudhën 1998/99, duke shënuar 12 qershorin 1999 si datën e humbjes.
3. AKP-ja ka procesuar kërkesat bashkë pasi ato pjesërisht janë të njëjta dhe të gjitha kanë të bëjnë me ngastrën e njëjtë kadastrale dhe objektet e njëjta.
4. Në mbështetje të kërkesës, pala *ndër të tjera* ka paraqitur në AKP dokumentet në vijim:

- Kopja e Vendimit nr. 02-463/167 të lëshuar nga Kuvendi Komunal i Pejës më 10 mars 1995 përmes të cilit (një pjesa e ngastrës) ngastrës nr. 451/12 (tokë për ndërtim urban) në sipërfaqe prej 00.14.50 ha dhe e shënuar në Listën Poseduese nr. 227 i është dhënë për shfrytëzim Kompanisë Ushqimore dhe tregtare të palës Përgjegjëse në ankesë “Polet” me qëllim të ndërtimit të një mulliri elektrik.
- Kopja e Kontratës mbi shfrytëzimin e tokës për ndërtim urban nr. 10-352/126 të lidhur më 4 prill 1995 në mes të palës përgjegjëse në ankesë dhe Fondit Social për Tokën Ndërtimore dhe Rrugore të Komunës së Pejës përmes së cilës palës përgjegjëse në ankesë i është dhënë në shfrytëzim ngastra kadastrale nr. 451/12. Neni 6 i kontratës specifikon se prona e dhënë në shfrytëzim mbetet Pronë Shoqërore kurse shfrytëzuesi i pronës do të fitojë të drejtën e përhershme të shfrytëzimit mbi tokën.
- Vendimin nr. 05-351/704 të lëshuar nga Administrata Komunale e Pejës, Departamenti për Çështje Ligjore për Urbanizëm, Shërbime Komunale, Banesore, Ndërtimore dhe Pronësore më 3 maj 1995 përmes së cilës kompania e palës përgjegjëse në ankesë kishte marrë pëlqimin për ndërtimin e mullirit elektrik në ngastrën kadastrale nr. 451/12.
- Kopjen e planit nr. 277 të lëshuar nga Departamenti për Kadastër i Republikës së Serbisë, Komuna Kadastrale Bellopojë, më 17 maj 1995 që rëndit ngastrën nr. 451/12 në emër të palës përgjegjëse në ankesë dhe të kompanisë së tij.
- Listën poseduese nr. 277 të lëshuar më 14 korrik 1995 nga Autoriteti për Kadastër i Republikës së Serbisë, Zyra për Kadastër e Komunës së Pejës, që rëndit ngastrën nr. 451/12 në emër të palës përgjegjëse në ankesë.
- Letrën njoftuese e adresuar AKP-së nr. 3/155/13 të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës më 25 mars 2013 përmes së cilës më vonë Agjencia ka deklaruar se në bazë të provave nga viti 1956, ngastra kadastrale nr. 451/12 ishte pronë shoqërore e shënuar në emër të K.B.I-së. Në bazë të vendimit nr. 05/463/2485/94 të datës 29 maj 1997 prona ishte bartur në emër të kompanisë së palës përgjegjëse në ankesë UTP “Polet”. Tani për tani, prona e kërkuar është e shënuar në emër të palës përgjegjëse në ankesë por baza ligjore e këtij transferimi është e panjohur për Agjencinë Kadastrale të Kosovës .

5. Njoftimi për kërkesat nr. KPA17993 dhe KPA29087 është bërë më 10 nëntor 2009. AKP-ja ka gjetur tokën e vërejtur në kërkesën nr.KPA17993 të zaptuar nga I.A. (tani e tutje: pala ankuese). Njoftimi për kërkesën nr. KPA28947 është bërë më 29 korrik 2011. AKP-ja ka gjetur pronën të zaptuar nga pala ankuese. Njoftimi për kërkesën nr. KPA29108 më 4 prill 2011 dhe për kërkesën nr. KPA29088 më 12 shkurt 2008.
6. Pala ankuese pretendon në të drejtën ligjore mbi një pjesë të ngastrën kadastrale nr. 451/12 duke pretenduar se gjyshi i tij e kishte në pronësi që nga vitet e 1930-ta. Ai ka dorëzuar përgjigjen ndaj kërkesës por nuk ka ofruar asnjë dokument në mbështetje të pretendimeve të tij.
7. Në bazë të raporteve të verifikimit të AKP-së dokumentet në vijim janë verifikuar pozitivisht:
 - Vendimi nr. 02-463/167 i lëshuar nga Kuvendi Komunal i Pejës më 10 mars 1995.
 - Kontrata mbi shfrytëzimin e tokës për ndërtim urban nr. 10-352/126 të lidhur më 4 prill 1995.
 - Vendimi nr. 05-351/704 të lëshuar nga Administrata Komunale e Pejës, Departamenti për Çështje Ligjore për Urbanizëm, Shërbime Komunale, Banesore, Ndërtimore dhe Pronësore më 3 maj 1995.
8. Pas verifikimit të listës poseduese nr. 277 AKP-ja siguroi në lëndë *ex officio* listën poseduese nr. 699¹ të Zonës Kadastrale Bellopojë, të lëshuar nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në Komunën e Pejës më 9 dhjetor 2008. Ngastra nr. 451/12 është regjistruar në këtë listë poseduese në emër të palës përgjegjëse në ankesë. Në bazë të zyrtarëve për kadastër ndryshimet ishin bërë më 2007 në bazë të konfirmimit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik nr. 09/330-5720, të datës 13 qershor 2007.
9. Me vendimin e datës 11 qershor 2013 (nr. KPCC/D/A/208/2013), Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës ka vendosur mbi kërkesat e bashkuara se prona e kërkuar gjendet në ngastrën kadastrale me numër 451/12 në listën poseduese 277 të Zonës Kadastrale Bellopojë, në Komunën e Pejës, dhe se pala përgjegjëse në ankesë ka vërtetuar se është pronar i 1/1 i pronës së kërkuar dhe se ka të drejtën e shfrytëzimit mbi këtë tokë. KKPK-ja ka urdhëruar se pala përgjegjëse në ankesë ka të drejtën e posedimit mbi pronën e kërkuar. KKPK-ja ka arsyetuar se pala përgjegjëse në ankesë ka dorëzuar vendimin e verifikuar mbi

¹ Në shkresa të ndryshme të lëndës është gjetur lista e njëjtë poseduese me informacione të njëjta por me data të ndryshme të lëshimit. Këtu përmendet vetëm njëra prej tyre pasi që janë të njëjta.

ndarjen nga viti 1995 dhe kontratën mbi shfrytëzimin. Në këtë vendim mbi ndarjen kompanisë së tij i është dhënë e drejta e shfrytëzimit mbi ngastrën, e klasifikuar si tokë për ndërtim urban. Pala përgjegjëse në ankesë më tutje ka dorëzuar edhe lejen e ndërtimit. KKPK-ja më tutje ka arsyetuar se pala përgjegjëse në ankesë nuk ka dorëzuar prova në mbështetje të pretendimeve të tij. KKPK-ja më tutje vëren se provat e dorëzuara nga pala përgjegjëse në ankesë nuk ishin dorëzuar në emrin e tij, por në emër të kompanisë së tij, por kompania nuk është person i ndarë juridik; në mënyrë efektive është emër komercial i palës përgjegjëse në ankesë. Prandaj, KKPK-ja ka arritur në përfundim se pala përgjegjëse në ankesë është pala e vërtetë e interesit, dhe se pala përgjegjëse në ankesë ka ofruar prova të mjaftueshme për të pranuar kërkesën.

10. Vendimi i KKPK-së për të pesë kërkesat është dorëzuar te pala përgjegjëse në ankesë më 20 gusht 2013.
11. I.A. , ka pranuar vendimin e KKPK-së për kërkesën nr. KPA28947 më 31 tetor 2013 dhe vendimin e KKPK-së për kërkesat e tjera më 2 shtator 2013. Bashkë me vendimin i është dorëzuar edhe një fletë njoftim mbi ankesat. Në vendimin e KKPK-së është shkruar se pala mund të paraqesë ankesë brenda 30 ditësh nga njoftimi i vendimit.
12. Pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së mbi të pesë kërkesat ndaras pranë Gjykatës Supreme më 18 qershor 2014. Bashkë me ankesën ka paraqitur një letër të vulosur me vulë të avokatit që mban datën 12 qershor 2014.
13. Gjykata Supreme ka regjistruar pesë ankesat siç përmendet në paragrafin 1.
14. Pala përgjegjëse në ankesë ka pranuar kopjen e ankesave më 25 gusht 2014. Më 27 gusht 2014 ka paraqitur përgjigjen.

Pretendimet e palëve:

Pala ankuese:

15. Pala ankuese pohon se nuk ka asnjë vërejtje për ta dorëzuar pronën e kërkuar ta pala përgjegjëse në ankesë por insiston se nuk është duke e shfrytëzuar të gjithë sipërfaqen e pronës. Ai është duke shfrytëzuar vetëm 150 ose 200 m² të ngastrës kadastrale nr. 451/12. Prandaj ai kërkon miqësisht nga KKPK-ja që së pari ta njoftojë pjesën e pronës që duhet t'ia dorëzojë palës ankuese dhe pastaj të caktohet afati për procedurën e dorëzimit.

Pala përgjegjëse në ankesë:

16. Pala përgjegjëse në ankesë pretendon se ankesa e palës ankuese ishte paraqitur pas afatit ligjor të përcaktuar me ligj. Prandaj propozon që ajo të refuzohet.

Arsyetimi ligjor:*Bashkimi i ankesave*

17. Në përputhje me Nenin 13.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, të ndryshuar me Ligjin nr.03/L-079, (tani e tutje: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50) Gjykata Supreme mund të vendosë mbi ankesat e bashkuara, kur ky bashkim i kërkesave është vendosur nga KKPK-ja në përputhje me nenin 11.3 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50. Ky nen lejon KKPK-në të marrë parasysh bashkimin apo shkrirjen e kërkesave me qëllim të marrjes së vendimeve kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.
18. Në këtë rast KKPK-ja në fakt ka bashkuar pesë kërkesa.
19. Përveç nëse parashihet ndryshe, dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore zbatohen *mutatis mutandis* në procedurën para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme në përputhje me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50. Në bazë të nenit 408.1 në lidhje me nenin 193 Ligjit për Procedurën Kontestimore, Gjykata Supreme mund t'i bashkojë lëndët përmes një aktvendimi nëse kjo do të siguronte efikasitet të gjykatës të lëndës.
20. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme vëren se përveç numrit të ndryshëm të lëndës për paraqitjen e ankesës përkatëse, faktet, bazat ligjore dhe çështjet e provave janë të njëjta në pesë lëndët. Përveç kësaj, arsyetimi ligjor i KKPK-së për këto kërkesa është i njëjti.
21. Prandaj ankesat janë bashkuar në një lëndë të vetme.

Pranueshmëria e ankesës

22. Ankesat janë të pasafatshme.
23. Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 përcakton si në vijim: “*Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala*

mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”.

24. Vendimi i KKPK-së është dorëzuar te pala ankuese të hënën më 2 shtator 2013 dhe të enjten më 31 tetor 2013. Pra afati kohor prej 30 ditëve ka mbaruar të mërkurën më 2 tetor 2013 dhe – në vazhdimin e ditës së parë të punës – të hënën më 2 dhjetor 2013. Prapëseprapë, pala ankuese ka paraqitur ankesën e tij më 12 qershor 2014. Ai nuk ka paraqitur asnjë arsyetim legjitim për këtë vonesë. Kjo do të thotë se ankesën e ka paraqitur jashtë afatit kohor prej 30 ditësh.
25. Prandaj ankesat duhet të hedhen poshtë në baza procedurale si të paafatshme në përputhje me nenin 13.3 nën-paragrafin (b) të o Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

Këshillë juridike:

Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky Aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Anna Bednarek , Gjyqtare e EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it